



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 3261/2022
Data: 11.05.2022

**PROCESVERBALI
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e katërt -IV- për vitin 2022 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 19.04.2022 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkyryetari i Komunës), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), **Sevime Bajramai** (Kryesuese e Komisionit të Aksionarëve), Përfaqësues i OSB-së, **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Informim). Kryesuesi pasi konstataoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstataoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2022.
3. Informatë për ndarjen e bursave.
4. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2022 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
5. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:-përveç pikave të rendit të punës të cilat i kemi paraprë në agjendë kemi edhe një kërkesë nga drejtoria për buxhet dhe financa për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2021 në vitin 2022, me të cilën kërkojnë që edhe kjo pikë të përfshihet në rend të punës. Për pikën shtesë hapi diskutimin nëse nuk ka e hedh në votim, rezultati i votimit ishte njëzëri. Për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka në tërësi e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës:-

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2022.
3. Informatë për ndarjen e bursave.
4. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2022 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
5. Kërkesë për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2021 në vitin 2022.
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin,

Sherif Berisha thekson:- faqe tre të plotësohet diskutimi imë: për këtë problem është bërë shumë zhurmë sepse mediatikishtë është potencu që keni inxhizime dhe ju keni bërë akuza që ka inxhizime që është bërë keqpërdorime me këto barna dhe si opozitë ju përshëndesim në këtë drejtim nëse ka keqpërdorim të kësaj natyre dhe qëndrojmë mbrapa që t'i ndiqni procedurat ligjore për këtë çështje.

nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

Lindita Ballazhi thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Nora Xhoni thekson:- performanca e të hyrave në krahasim me tre mujorin e viti të kaluar është një rritje prej 20.67 %, kërkoi sqarim për këtë çështje.

Sherif Berisha thekson:- kodet buxhetore të cilat vendosen , a ekziston mundësi që nëse bëhet fjalë për arsim të mbesin të gjitha në afërsi e jo të shpërndahen.

Refet Kalisi thekson:- shpenzime të derivateve në këtë tre mujorë nuk i keni paraqitur. A keni pasur shpenzime?

Lindita Ballazhi thekson:- është rezultat i inkasimit të tatimit në pronë , pra inkasomi i borxheve nga vitet e kaluara. Janë në fund dhe është edhe administrata e arsimit e jo administrata komunale. Kemi pasur shpenzime por ende nuk i kemi paguar për shkak se nuk na janë dërguar faturat.

U VOTUA RAPORTI FINACIAR PËR PERIUDHËN JANAR –MARS 2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Informatë për ndarjen e bursave.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Isni Luri thekson:- kemi pasur katërdhjetë e një aplikues , e që prej tyre tridhjetë kanë përfituar bursë prej komunës , ndërsa njëmbëdhjetë të tjera kanë përfituar prej bizneseve.

Refet Kalisi thekson:- vërejtja kam te emrat për shkak se nuk lexohen sepse janë shënuar me shkronja të vogla.

Sherif Berisha thekson:- pavarësisht që të gjithë studentët që kanë aplikuar kanë marr bursë është mirë që në të ardhmen ta ndryshojmë rregulloren në mënyrë që të përfshihen edhe studentët të cilët studiojnë jashtë shtetit të Kosovës.

Isni Luri thekson:-sa i përket shkrimit është pjesë e tabelës të cilën kemi dashur me përfshirë krejt. Kërkesë kemi prej studentëve të cilët studiojnë jashtë shtetit të Kosovës që të janë të përfshirë në bursën e komunës. Gjatë plotësim ndryshimit që do të bëhet duhet t'i dallojmë kuadrat deficitare të cilat janë.

Kryesuesi thekson:- jam dakord që të bëhet plotësim ndryshimi i rregulllore për subvencione sepse në Universitetin e Tetovës kemi studentë të cilët studiojnë në fakultet Mjekësisë dhe janë kuadra deficitare, mirëpo duhet ta kemi parasysh që duhet të përfshihen edhe studentët të cilët studiojnë edhe në Shqipëri. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA INFORMATA PËR NDARJEN E BURSAVE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Raporti finansiar për periudhën Janar – Mars 2022 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevime Bajrami thekson:- materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë propozim mund të parashtroni.

Sherif Berisha thekson:- kërkoj që NLP pastrimi SH t'i bëhet auditim për kohën që ka kaluar në mënyrë që të hiqen dilemat e më hershme sepse shumë fjalë qarkullojnë, pra të hiqen fjalët dhe dilemat dhe të vazhdojmë më tutje. Kërkoj sqarim të formulari që është shënuar shofer dhe shofer mbikëqyrës i punëtorëve në teren sepse edhe paga dallon.

Refet Kalisi thekson:- sa e ekonomi familjare kanë kontrata dhe nuk e kryejnë pagesën.

Sevime Bajrami thekson:- besoj që do të kemi një auditim në një të ardhme të afërt. Këtë listë nuk e kemi ende edhe pse e kemi kërkuar nga kompania dhe kanë potencuar se do të punojmë në këtë drejtim. Paga dallon se është edhe mbikëqyrës i punëtorëve.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA RAPORTI FINACIAR PËR PERIUDHËN JANAR-MARS 2022 I NPL PASTRIMI SH A QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Kërkesë për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2021 në vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- kërkesa për bartje është bërë pak me vonesë për shkak se nuk kanë qenë të miratuara pasqyrat financiare nga Ministria. Të hyrat e bartura nga viti 2020 në vitin 2021 kanë qenë në shumën prej 57,779.88 €, prej tyre janë shpenzuar në shumën prej 57,001.74 €, kanë mbetur edhe 778.14 €. Të hyrat vetanake të realizuara gjatë vitit 2021 kanë qenë në shumë prej 325,140.90 €, prej tyre janë të shpenzuara 253,181.28 €, mbetja nga te hyrat e vitit 2021 është 71,959.62 € kurse për bartje në vitin 2022 janë gjithsej 72,737.76 €. Pra në total, të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit 2020 dhe 2021 janë në shumën prej 72,737.76 €. Në materia i keni të paraqitura mjetet financiare se në cilat kategori do të barten.

Refet Kalisi thekson:- shuma prej 18,000.00 € për gjelbërimi i disa hapësirave publike po më duket shumë, kërkoj sqarim se ku do të bëhet.

Nexhmedin Daci thekson:- do të bëhet rregullimi i hapësirave gjelbëruese para komunës dhe mbrapa komunës, rreth rrotullimi dhe para objektit të postës. Mund të duket shumë madhe sepse do të bëhet kupëzim, gjelbërim, sistem të ujites.

Sherif Berisha thekson:- po shihet që nuk është planifikuar që qytetit me ju ndërruar pamja sepse mundë ti shihni objektet e vogla, ndërtesat nuk është planifikuar që me i suvatuar. Është mirë që me pasur një projekt edhe për qendrën edhe për vijën kufitare në mënyrë që me pasur një pamje më të mirë. Për gjelbërimin nuk kam vërejtje. Te projekti për parkun qytetit te rruga “Isa Berisha” me sa jam i njoftuar kodë buxhetorë ka pasur dhe ju keni menduar me dediku mjete, kërkoi sqarim.

Lindita Ballazhi thekson:- i kemi dedikuar mjetet për shkak se mjetet të cilat janë ndarë prej Qeverisë nuk mjaftojnë për me realizuar atë projekt.

Nexhmedin Daci thekson:-për realizimin e projektit të parkut të qytetit mjetet financiare në shumë 100 000 € janë nga Qeveria, 40 000 € i kemi planifikuar me buxhet, mirëpo për realizimin e këtij projekti besoj që do të shpenzohen më shumë se 200 000 € dhe e kemi paraparë edhe grantin e performancës për me realizuar këtë projekt. Sa i përket suvatimit të ndërtesave ata janë dëmtuar bejgi shumë dhe çdo investim është punë e kotë dhe realisht duhet me krijuar mundësi për ndërtimë të reja përmes investitorëve të rinj por janë disa probleme me çështje të pronave.

Sherif Berisha thekson:- asnjë herë nuk është investuar në këto objekte. Është mirë me biseduar me pronarët e banesave që me gjetur një gjuhë të përbashkët që edhe ata me investuar edhe komuna që me bërë një pamje më të mirë. Unë mendoj që me pak mjete financiare mund të bëjmë ndryshime te objektet.

Sevdi Dernjani thekson:- jemi duke punuar në hartat zonale dhe pa u kryer hartat zonale nuk mundemi me planifikuar asgjë. Në momentin që të përfundojnë hartat zonale do ta diskuton kryetari i komunës së bashku me ekzekutivin apo nëse është e nevojshme edhe në diskutim publik në mënyrë që me marr një vendim sa më të mirë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA KËRKESA PËR BARTJNE E MJETEVE TË PASHPENZUARA NGA TË HYRAT VETANAKË TË VITIT 2021 NË VITIN 2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:- në fshatin Gorancë janë ndërtuar disa shtëpia afér varrezave e Serbëve dhe këtyre ditëve është ndërtuar edhe një shtëpijë, a ka dhënë leje dikush për ndërtimin e këtyre shtëpive. Sipas informatave që kam ka pas qytetarë të komunitetit Serb të cilët kanë qenë në komunë dhe janë interesuar se çka po ndodhë në atë pjesë. Kërkoi informacion për çështjen e Hidrocentralit te restorant Bambi dhe lokalet të cilat janë në atë pjesë a kanë leje për shkak se ishin duke e pushtuar lumin Lepenc. Drejtoria për zhvillim ekonomik a ka pasur takim me OJQ Labin për shkak se qytetarët po pyesin për subvencionimet dhe a keni konkretisht diçka rreth kësaj se çka do të ketë në këtë vit për shkak se po flitet se janë kthyer 20 000 € prapë të grantit që ka qenë më herët për shkak se nuk kanë pasur kujt me ja shpërndarë

Nexhmedin Daci thekson:- nuk kam informacione për këtë çështje por më herët ka pasur kërkesa për mirëmbajte por u kam potencuar se nuk kemi mundësi buxhetore. Për momentin nuk ka asgjë sa i përket Hidrocentralit kompania e ka pëlqimin të cilin ja ka dhënë kuvendi i komunës. Lokalet nuk kanë kërkuar leje në urbanizëm për zgjerim.

Kryesuesi thekson:- te çështja e pëlqimit të cilin e ka dhënë kuvendi për hidrocentrali e ka një periudhë kohore që duhet me i filluar punimet.

Majlinda Kaloshi thekson:- personalisht nuk kam qenë pjesë e takimit por ka qenë drejtori për bujqësi dhe më konkretisht mund tu jep sqarime.

Sevdi Dernjani thekson:- Labi është OJQ e cila është në kuadër të kompanisë “Sharrcem” dhe ne nuk kemi kompetencia për atë OJQ sepse ata i shpërndajnë subvencionet në bazë të kritereve që i përcaktojnë vetë ata, ndërsa me komunën e kanë vetëm bashkëpunimin dhe asgjë tjetër.

Kryesuesi thekson:- me çështje të kompanisë “Sharrcem” duhet të merret edhe komuna për shkak se dëmet të cilat po i shkakton kompania po arsyetohet te qytetarët se jemi duke ju ndihmuar përmes OJQ Labi dhe është mirë që me ju sqaruar qytetarëve përmes drejtorisë për zhvillim ekonomik dhe drejtorisë për bujqësi.

Sherif Berisha thekson:- përveç ekzekutivit që mund të ketë takime, propozoj që edhe nga asambleja komunale që me kërkuar një takim me përfaqësuesit e kompanisë “Sharrcem” .

Kryesuesi thekson:- do të formohet bordi prej tre personave që me pasur takime me kompaninë Sharrcem dhe besoj që do të funksionon. Si asamble ka edhe forma të tjera për me bashkëpunuar me kompaninë “Sharrcem” por varet se a kemi vullnet për me bërë diçka për të mirë. OJQ Labi ju kërkon përqindje aplikuesëve për projekte dhe është mirë të dihet ajo përqindje se ku shpenzohet sepse kompania “Sharrcem” e financon me një shumë të mirë këtë OJQ , pra duhet të dimë më shumë për këtë çështje.

Sherif Berisha thekson:-më herët ka pasur kërkesa për me shkuar në “ Sharrcem ” dhe nuk ju ka mundësuar me arsyetim se kemi takim me ekzekutiv dhe unë kërkoj që mos të na përsëritet e njëjtë situatë.

Refet Kalisi thekson:- sa hektarë ju kanë dhënë kompanisë “Sharrcem” për shfrytëzimin e gurit.

Nexhmedin Daci thekson:- ju kanë dhënë ata të cilët i ka pasur por më hollësish mundem me shikuar dhe ju njoftoj nuk është problem.

Kryesuesi thekson:- në kuvend ju ka dhënë pëlqimi për mbi pesëmbëdhjetë hektarë në vitet e më hershme dhe z.Nexhmedin Daci si drejtor tash ka mundur me i dhënë pëlqim për me operuar në lejen e më hershme , dhe unë si Kryesues i Kuvendit të Komunës nuk jam në dijeni a i ka dhënë parcel tjetër dhe nëse i ka dhënë është dashur me u pyetur komunitetii fshatit Seçishtë.

Nexhmedin Daci thekson:- për prona të cilat janë në emër të komunës kompetent është kuvendi komunal , ndërsa për pronat të cilat nuk janë në emër të komunës nuk jemi kompetent. Vendimin të cilin e keni marr në kuvend është i jashtëligjshëm për shkak se për pronën të cilën nuk është e jotja nuk mundesh me dhënë pëlqim.

Kryesuesi thekson:- prona për të cilën keni dhënë pëlqim është në zonën kadastrale të Seçishtës dhe si mbas teje komuniteti i fshatit Seçisht nuk është asgjë, por me ligj duhet me pasur parasysh komunitetin. Nëse ke dhënë pëlqim për pronën që është dhënë më herët është në rregull, mirëpo pronë me i dhënë kushdo që kërkon mendoj që nuk duhet ti ipet për shkak se ka procedura sepse duhet të merret komuniteti parasysh dhe arsyeva e dhënies së pronës.

Nexhmedin Daci thekson:- ne japim vetëm pëlqim dhe në momentin që nisë ndonjë aktivitet kompania është e obliguar me mbajtur dëgjim publik për shkak se duhet të merr edhe pëlqim mjedisorë dhe qytetarët mund t'i paraqesin vërejtjet e tyre sepse për pronat e huaja na nuk vendosim . Komuna mundet mos me i dhënë pëlqim me refuzuar por KPMM-ja i jep pëlqim nëse ajo e vlerëson se është me interes të veçantë.

Kryesuesi thekson:- është dashur me pyetur komunitetin se a keni pasur ndonjë marrëveshje , a ka premtuar për punë diçka kompania “Sharrcem” për shkak se komunitetit mundet me ju bërë e padrejtë sepse ajo pjesë ka qenë vakëf dhe po të ishe në kadastër pjesa ku është tu operuar kompania do të kishe problem me Bashkësinë Islame. Nuk është mirë me i dhënë pëlqim dikujt pa i njofuar banorët e fshatit. Pavarësisht se në emër të kujt është prona drejtoria e urbanizmit është përgjegjëse që duhet t'i jep dikujt pëlqim sepse pronat janë në territorin e komunës së Hanit të Elezit dhe duhet të bashkëpunoni me administratorët e lagjeve. Nuk jemi kundër askujt por duhet të zbatohen procedurat .

Refet Kalisi thekson:- në vitin 2013 i kemi kërkuar kushte kompanisë “Sharrcem” dhe na i ka ofruar dhe ka potencuar se tridhjetë punëtorë do të punësohen kur të bëhet eksplotimi i gurit dhe asgjë nuk kemi përfituar prej atyre që ata janë zotuar që do të përfiton komuniteti i fshatit Seçishtë. Është mirë të vetët komuniteti për shkak se ka probleme sepse i kemi pronat dhe bëhet pluhur dhe banorët e fshatit Seçishtë mendojnë me rregullu ndonjë vikendica sikur te Vilt.

Nexhmedin Daci thekson:- nëse kemi pasur marrëveshje me kompaninë “Sharrcem” ju mund të kërkonit por ende nuk ka filluar me ndonjë aktivitet.

Kryesuesi thekson:- sa i përket marrëveshjes kompania “Sharrcem” e ka ndryshuar mënyrën e veprimtarisë dhe për atë ka mundur me ndryshuar te çështja e punëtorëve për shkak se në fillim kanë dashur me operuar vetë si “Sharrcem”, mirépo tash kanë kontraktuar kompani private. Në takim si administratorë që kam pasur me përfaqësuesit e kompanisë “Sharrcem” më kanë premtuar për realizim të projekteve si pyllëzimin e kodrës , rregullimin e pendës për çështjen e ujit të fshatit, rregullimin e një fushe rekreative sportive në vendin e quajtur Kodra. Të gjitha këto projekte kanë pasur me u realizuar por kërkesa me u parashtruar prej komunës.

Nexhmedin Daci thekson:- kompania “Sharrcem” nuk është tu zhvilluar asnjë aktivitet në atë pjesë por. Kompania “Alba Grup” është tu operuar në parcelën të cilën e ka blerë prej z.Muhamed Kalisi e cila nuk ka të bëjë me “Sharrcem”.

Sherif Berisha thekson:- shujtat për nxënësit kanë filluar me u shpërndarë dhe kishte qenë mirë si drejtori e arsimit me kërkuar që shujta me ju nda edhe tri klasave të cilët janë parashkollarë. Kërkoj sqarim se pse nuk është kryer edhe pagesa tjeter e shujtave për arsimtarët.

Hisni Luri thekson:- kërkeshën e kam parashtruar dhe shujta janë tu ndarë edhe për para shkollorët. Procedurën për pagesën e kemi dorëzuar në Ministri të Financave por ata nuk i kanë kryer dhe nuk na kanë dhënë asnjë sqarim. Do të procedohen përsëri.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës , nëse nuk ka e shpallim të mbyllur mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:17.

Procesmbajtësi

Ayni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta